LIGJ
Nr. 106/2015

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS PËR ASISTENCËN TEKNIKE PËR PROJEKTIN "PUNIME INFRASTRUKTURORE KOMUNALE NË ZONËN E ALPEVE SHQIPTARE" (ASISTENCË TEKNIKE NË KUADËR TË INVESTIMEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR)

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e grantit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës për asistencën teknike për projektin "Punime infrastrukturore komunale në zonën e Alpeve Shqiptare", (asistencë teknike në kuadër të investimeve në Ballkanin Perëndimor), sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 1.10.2015

Shpallur me dekretin nr. 9278, datë 15.10.2015 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

DRAFTI 27.5.'15
WBIF: WB6-ALB-SOC-14
CEB: FIP 17187 (2010)/LD 1853 (2014)

ASISTENCË TEKNIKE "PËR PUNIMET E INFRASTRUKTURËS KOMUNALE NË ZONËN E ALPEVE SHQIPTARE" (ASISTENCË TEKNIKE NËN KUADRIN E INVESTIMEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR)

MARRËVESHJE GRANTI
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS PËR ZHVILLIM TË KËSHILLIT TË EVROPËS

Palët e kësaj Marrëveshjeje granti (më poshtë e referuar si "Marrëveshja") janë Republika e Shqipërisë, që vepron me dhe nëpërmjet Ministrisë së saj të Financave, bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3, Tiranë, Shqipëri, i përfaqësuar nga ëSHËNONI EMRIN E NËNSHKRUESIT] (vendi përfitues) dhe Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, Organizatës Ndërkombëtare, me seli në 55 Avenue Kléber, 75116 Paris, Francë, të përfaqësuar nga ëSHËNONI EMRIN E NËNSHKRUESIT] (më poshtë i referuar si "CEB", bashkërisht të referuara si "Palët", secila një "Palë").

Duke pasur parasysh:

A) Në shkurt 2008, Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Banka Evropiane e Investimeve (BEI), Komisioni Evropian (komisioni) dhe CEB (të referuara bashkërisht më poshtë si "organizatat partnere" dhe secila një "organizatë partnere"), ranë dakord për të krijuar Kuadrin e Investimeve të Ballkanit Perëndimor (KIBP) me qëllim rritjen e harmonizimit dhe bashkëpunimit të investimeve për zhvillimin social-ekonomik të Ballkanit Perëndimor. Nisma për themelimin e KIBP-së u mirëprit nga Këshilli Ekonomik dhe i Çështjeve Financiare të Bashkimit Evropian, në maj 2008, dhe më pas u miratua nga Këshilli Evropian në qershor 2008.

B) Për të arritur objektivat e KIBP-së, organizatat partnere krijuan një strukturë të përbashkët të grantit (e referuar më poshtë si "SPG") dhe një strukturë të përbashkët të kreditimit, për të ofruar një paketë të integruar të financimit të granteve dhe huave në mbështetje të infrastrukturës prioritare dhe zonave të tjera të zhvillimit social-ekonomik. SPG-ja përfshin burimet e vëna në dispozicion nga ana e organizatave partnere, si dhe burimet e kontribuara nga shtetet donatore. Burimet e shteteve të tilla donatore janë të grumbulluara dhe administrohen në një fond të përbashkët për bashkëpunim - Fondi Evropian i Përbashkët për Ballkanin Perëndimor (FEPBP) i bashkëmenaxhuar nga BERZH-i dhe BEI.

C) Vendi përfitues ka kërkuar ndihmë financiare në bazë të KIBP-së për Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Shqipërisë ("FSHZH" ose "përfituesi përfundimtar") për të siguruar shërbimet e konsulentëve (shërbimet e këshillimit) për të

ndihmuar përfituesin përfundimtar, FSHZH-në, në përgatitjen e projektit të tij të "Masterplanit dhe studimit të fizibilitetit për punimet komunale në infrastrukturë në zonën e Alpeve Shqiptare, i përbërë nga: i) Masterplani për zhvillimin e zonës së Alpeve Shqiptare; dhe ii) Studimi i fizibilitetit për veprat e mëdha të infrastrukturës komunale (projekti), me synimin për të bashkëfinancuar këtë projekt me një hua nga CEB-i (nën projektin për "Punimet komunale të infrastrukturës në zonën e Alpeve Shqiptare", referenca e identifikimit të projektit të CEB-it: FIP 17187 (2010)/LD 1853 (2014)). Shërbimet e konsulencës janë përshkruar më hollësisht në përshkrimin teknik në shtojcën A të këtij dokumenti (përshkrimi teknik).

D) Më 7 dhjetor 2011, komiteti drejtues miratoi livrimin e fondeve për këto shërbime të konsulencës, dhe është rënë dakord për t'i financuar nga buxheti përkatës i caktuar nga FEPBP-ja dhe për të caktuar CEB-in si institucion drejtues financiar.

E) CEB-i, me burimet e siguruara nga FEPBP-ja në bazë të Marrëveshjes së zbatimit, në fuqi prej datës 27 qershor 2014, ndërmjet CEB-it dhe BERZH-it me pëlqimin e BEI-t (me BERZH-in dhe BEI-n, duke vepruar si bashkëdrejtues të FEPBP-së), dëshiron të lëshojë një grant (granti i FEPBP) për vendin përfitues, në mënyrë që të sigurojë fonde për shërbimet e konsulencës për të ndihmuar përfituesin përfundimtar, FSHZH, në përgatitjen e projektit.

F) Qëllimi i Marrëveshjes ndërmjet CEB-it dhe vendit përfitues është përcaktimi i termave dhe kushteve, në lidhje me i) transferimin dhe përdorimin e grantit të FEPBP-së; ii) zbatimin e shërbimeve të konsulencës (në përgatitjen e zbatimit të projektit); dhe iii) raportimin dhe auditimin në përdorimin e grantit të FEPBP-së.

FSHZH-ja, përfituesi përfundimtar do të hyjë në kontrata konsulence (kontratat e konsulencës) me konsulentët (konsulentët) për të marrë shërbimet e konsulencës të nevojshme për të përgatitur projektin.

Si rrjedhojë, palët bien dakord si më poshtë:

Përkufizimet

Në këtë Marrëveshje, termat dhe shprehjet e mëposhtme të përcaktuara do të kenë kuptimin e mëposhtëm, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe:

"Data e mbylljes" nënkupton datën pas së cilës nuk mund të kërkohen disbursime të mëtejshme nga përfituesi përfundimtar, të përcaktuar në paragrafin 1.5 më poshtë.

"Data e përfundimit" do të thotë data e përfundimit në kuadër të projektit, siç përcaktohet në shtojcën A të këtij drafti.

"Rregulloret e huas" nënkupton rregullat e huas të CEB-it, të miratuara nga Rezoluta e Këshillit Administrativ të CEB-it 1562 (2013).

Referencat në këtë Marrëveshje të neneve, seksioneve përshkruese, skeduleve, anekseve dhe shtojcave janë referenca përkatësisht nga nenet, përshkrimet, oraret, anekset dhe shtojcat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 1
Granti i FEPBP-së

1.1 Shuma e grantit të FEPBP-së: Sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në vijim në këtë Marrëveshje, CEB-i është i gatshëm të vendosë në dispozicion për vendin përfitues, ashtu si edhe vendi përfitues pranon grantin e FEPBP-së në një shumë totale prej 1,000,000 eurosh (një milion euro).

Kjo shumë korrespondon me grantin e FEPBP-së të miratuar nga komiteti drejtues i KIBP-së, më 7 dhjetor 2011.

1.2 Procedurat e pagesës:

Granti i FEPBP-së do të disbursohet për vendin përfitues sipas kërkesës dhe duke iu nënshtruar kushteve të paragrafit 1.4 të këtij neni (kushtet e pagesës).

CEB-i do të disbursojë grantin e FEPBP në këste (secila një "Këst"). Shuma e kështit të parë do të jetë e barabartë me 150.000 euro (njëqind e pesëdhjetë mijë euro), që përfaqëson pesëmbëdhjetë për qind 15% të shumës totale të grantit të FEPBP-së.

Vendi përfitues, nëpërmjet përfituesit përfundimtar, FSHZH-së, do të paraqesë me letër pranë CEB-it kërkesën e disbursimit (kërkesa e disbursimit), që kryesisht ka formën e përcaktuar në shtojcën B të këtij dokumenti, së bashku me çfarëdo dëshmie që kërkohet sipas paragrafit 1.4 të këtij neni (Kushtet e pagesës) ndaj CEB-it. Vendi përfitues pranon se pagesa e kryer për vendin përfitues në vijim të kërkesës së tillë do të përbëjë disbursimin si më poshtë.

Vendi përfitues, nëpërmjet Ministrisë së Financave, do të hapë: i) në Bankën e Shqipërisë, Banka Qendrore e Shqipërisë, me seli në Tiranë, një llogari të dedikuar për grantin e FEPBP-së në të cilën CEB-i do të transferojë të ardhurat e grantit të FEPBP-së (llogaria e projektit për grantin e FEPBP-së); dhe ii) në një bankë tregtare, një llogari të dedikuar për projektin dhe për projektin AT, për të cilin Ministria e Financave do të transferojë të ardhurat e grantit të FEPBP-së që do të përdoren nga përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja (Llogaria e veçantë për

grantin e FEPBP-së). Përfituesi përfundimtar, në emër të vendit përfitues, do t'i komunikojë CEB-it detajet e këtyre llogarive pas hapjes së tyre.

Çdo interes negativ i grumbulluar në llogarinë e projektit për grantin e FEPBP-së ose llogarinë e veçantë për grantin e FEPBP-së do të mbulohen nga vendi përfitues.

Vendi përfitues do të jetë përgjegjës për të vënë në dispozicion të përfituesit përfundimtar fondet e dhëna në llogarinë e veçantë për grantin e FEPBP-së për zbatimin e shërbimeve të konsulencës.

CEB-i do të depozitojë çdo këst në llogarinë e projektit për grantin e FEPBP-së.

1.3 Valuta: Granti i FEPBP-së do të disbursohet në euro (EUR). Çdo shumë për t'u paguar nga vendi përfitues ndaj CEB-it sipas kësaj Marrëveshjeje do të paguhet në euro (EUR). Të gjitha llogaritë financiare dhe deklaratat duhet të shprehen në euro (EUR).

1.4 Kushtet e pagesës:

Disbursimi i parë, në pajtim me paragrafin 1.2 të këtij neni (Procedurat e pagesës) është i kushtëzuar pas marrjes nga CEB-i prej vendit përfitues, nëpërmjet përfituesit përfundimtar, FSHZH-së, në formë dhe përmbajtje të pranueshme të origjinalit ose kopjes së njësuar me origjinalin të kontratës së parë të konsulencës të nënshkruar, në lidhje me të cilën, për shmangien e dyshimit, ndërmarrjet e veçanta të përcaktuara në paragrafët 4.2 (kontratat me konsulentët) dhe 4.6 (përzgjedhja e konsulentëve) të nenit 4 më poshtë, duhet të jenë përmbushur.

Çdo disbursim, përveç të parit, më tej do t'i nënshtrohet marrjes nga CEB-i prej vendit përfitues, nëpërmjet përfituesit përfundimtar, FSHZH-së, të provave të dokumentuara të pranueshme për CEB-in sipas shtojcës D, që brenda 6 muajve të ardhshëm pas datës së disbursimit, të specifikuara në kërkesën e disbursimit, përfituesi përfundimtar do të ketë kryer shpenzimet (neto nga tatimet) në lidhje me fraksionin e shërbimeve të konsulencës që do të financohen nga CEB-i në një shumë të paktën të barabartë me totalin e: i) 100% të shumës së të gjitha kësteve të disbursuara më parë; dhe ii) 100% të shumës së kështit që do të disbursohet.

Çdo pagesë do t'i nënshtrohet pranimit nga CEB-i të raporteve dhe rezultateve (siç është përcaktuar në nenin 7 më poshtë) të paraqitura nga vendi përfitues, nëpërmjet përfituesit përfundimtar, FSHZH-së, që nga disbursimi i mëparshëm.

Çdo disbursim i kryer para shpenzimeve do t'i nënshtrohet marrjes nga CEB-i prej vendit përfitues, nëpërmjet përfituesit përfundimtar, FSHZH-së, brenda 6 muajve nga data e disbursimit, të kopjeve të faturave të paguara nga përfituesi përfundimtar për konsulentët. Kopjet e faturave do të shoqërohen nga një raport, mbi këto fatura, prej një audituesi të jashtëm të pavarur të punësuar nga përfituesi përfundimtar dhe të paguar prej të ardhurave nga granti i FEPBP-së ose vendi përfitues në rast se burimet e grantit të FEPBP-së në dispozicion janë të pamjaftueshme dhe ky raport duhet të jetë në formë dhe përmbajtje të pranueshme për CEB-in. Nëse ndonjë pjesë e provave të ofruara nuk është e kënaqshme për CEB-in, CEB-i mund të disbursojë proporcionalisht më pak se shuma e kërkuar në disbursimin e ardhshëm, pa rënë ndesh me paragrafin 1.2 të këtij neni (procedurat e pagesës).

Dëshmi të dokumentuara, duke përfshirë faturat, të paraqitura pranë CEB-it nga vendi përfitues, nëpërmjet përfituesit përfundimtar, FSHZH-së, për plotësimin e kushteve të parashikuara sipas këtij paragrafi (1.4) të këtij neni (kushtet e pagesës) nuk do të paraqiten më shumë se një herë për secilin disbursim.

1.5 Data e mbylljes

Data e mbylljes është 31 dhjetor 2016.

Neni 2

Kushtet për përdorimin e grantit të FEPBP-së

2.1 Përdorimi i të ardhurave të grantit: Granti i FEPBP-së, i vënë në dispozicion nga CEB-i, do të përdoret ekskluzivisht për financimin e shërbimeve të konsulencës në përgatitjen e projektit (siç përshkruhet në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje).

Taksat (duke përfshirë tatimin e vlerës së shtuar), doganat dhe tarifat e importit ose çdo detyrim tjetër nuk përfshihet në financimin me grantin e FEPBP-së. Të gjitha taksat, detyrimet, taksat dhe tarifat e tjera apo përjashtime për mallrat, punimet dhe shërbimet që do të ndërmerren në kuadër të projektit do të rregullohen nga legjislacioni i vendit përfitues.

2.2 Çdo fond i mbetur i pashpenzuar pas datës së përfundimit të projektit (siç përcaktohet në shtojcën A) ose ndonjë shlyerje e grantit të FEPBP-së, në përputhje me Marrëveshjen, do të depozitohet në euro në llogarinë e mëposhtme për FEPBP-në të CEB-it, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe:

Nr. i llogarisë IBAN: DE44500700100928738400
Emri i mbajtësit: Banka për Zhvillim e Këshillit të Europës
Ref: WB6-ALB-SOC-14

Emri bankës:	Deutsche Bank AG Frankfurt
Adresa e bankës:	Taunusanlage 12, 60325 Frankfurt am Main Germany
SWIFT BIC:	DEUT DE FF

2.3 Vendi përfitues duhet të marrë të gjitha masat e duhura që gjithmonë të pranojë dhe të bëjë publike se fondet për shërbimet e konsulencës në përgatitjen e projektit janë marrë nga FEPBP-ja nëpërmjet CEB-it.

Në veçanti, informacioni i dhënë për palët e interesuara të projektit, për medien, si dhe çdo material promovues duhet të pranojë se shërbimet e konsulencës në përgatitjen e projektit janë kryer "me financim nga GRANTI I FEPBP-së i marrë nëpërmjet BANKËS SË ZHVILLIMIT TË KËSHILLIT TË EVROPËS" (me germa kapitale). Njohjes së CEB-it dhe FEPBP-së, duke përfshirë logot përkatëse, duhet t'i jepet dukshmëri e qartë për sa i përket madhësisë dhe rëndësisë. Përveç kësaj, kur logoja e FSHZH-së shfaqet në botime, logot e CEB-it dhe FEPBP-së duhet të shfaqen të paktën po aq dukshëm.

Raportet e veçanta për zbatimin e shërbimeve të konsulencës, të përgatitura nga përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja apo konsulentët /promovuesit e shërbimeve të konsulencës të financuara me të ardhurat e grantit të FEPBP-së duhet të përmbajnë paralajmërimin e mëposhtëm:

"Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, nën kuadrin e investimeve të Ballkanit Perëndimor, të marrë nëpërmjet Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura janë ato të (emri i autorit) dhe si rrjedhojë në asnjë mënyrë nuk mund të kuptohen si pasqyrim i opinionit zyrtar të Kontribuuesve të Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor, BERZH-së, si bashkëmenaxher i Fondit të Përbashkët Evropian për Ballkanin Perëndimor ose Bankës për Zhvillim të Këshillit të Evropës, si institucioni financiar drejtues në lidhje me projektin."

2.4 Raportet vjetore të progresit dhe raporti përfundimtar, të përcaktuara në nenin 7 të Marrëveshjes, duhet të përfshijnë masat e marra nga përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja për të siguruar dukshmërinë e CEB-it dhe FEPBP-së.

Neni 3
Përgjegjësia për shërbimet e konsulencës

3.1 Vendi përfitues cakton FSHZH-në si subjektin zbatues duke u bazuar te shërbimet e konsulencës.

FSHZH-së do t'i besohet menaxhimi dhe mbikëqyrja e shërbimeve të konsulencës. Në çdo rast, përgjegjësia për të përmbushur të gjitha detyrimet sipas marrëveshjes mbetet mbi vendin përfitues.

3.2 FSHZH-ja duhet të mbajë CEB-in të informuar për progresin e shërbimeve të konsulencës, duke ofruar për CEB-in informacion dhe raporte, me kopje për Ministrinë e Financave, të kërkuar sipas neneve 6 dhe 7 të Marrëveshjes.

Neni 4
Sipërmarrjet e veçanta

4.1 Përdorimi i të ardhurave të grantit: Vendi përfitues merr përsipër të sigurojë që përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja, do të përdorë të ardhurat e grantit të FEPBP-së vetëm për financimin e shërbimeve të konsulencës.

4.2 Kontratat me konsulentët: Vendi përfitues garanton se përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja do të marrë përsipër:

i) të lidhet me CEB-in në mënyrë që mos të marrë kundërshtimin e tij për termat dhe kushtet e kontratave të konsulencës (duke përfshirë termat e referencës, procedurat e zbatueshme të prokurimit, dokumentet e tenderit para fillimit të procesit të përzgjedhjes së tenderit, si dhe dhënien e kontratës në fund të procedurës së tenderit);

ii) të mos anulojë, ndryshojë ose pezullojë kontratat e konsulencës pa marrëveshjen paraprake me shkrim të CEB-it.

4.3 Kujdesi dhe devotshmëria: Përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja, duhet të përdorë grantin e FEPBP-së në përputhje me progresin e shërbimeve të konsulencës dhe duhet të investoje të gjithë kujdesin dhe devotshmërinë e nevojshme për zbatimin e duhur të shërbimeve të konsulencës.

4.4 Shpenzimet e rritura: Nëse kostoja e përfundimit të shërbimeve të konsulencës tejkalon buxhetin fillestar të treguar në kontratat e konsulencës, Republika e Shqipërisë, në cilësinë e saj si vendi përfitues, duhet të garantojë që të jenë në dispozicion burimet shtesë financiare për përfundimin e shërbimeve të konsulencës, pa iu drejtuar CEB-it. Planet për të financuar shpenzimet e rritura do t'i komunikohen CEB-it pa vonesë. Në çdo rast, CEB-i nuk merr përsipër të mbulojë asnjë shpenzim më të lartë se shuma e grantit të FEPBP-së, të përcaktuar sipas nenit 1 të Marrëveshjes.

4.5 Zbatimi i Shërbimeve të Konsulencës: Vendi përfitues, nëpërmjet përfituesit përfundimtar, do të garantojë që shërbimet e konsulencës, pasi të mund të ripërcaktohen herë pas here me miratimin e CEB-it, të jenë kryer dhe përfunduar brenda afatit të parashikuar në kontratat e konsulencës apo ndonjë afat tjetër që mund të

miratojë CEB-i.

4.6 Përzgjedhja e konsulentëve: Vendi përfitues merr përsipër se përfituesi përfundimtar do të zgjedhë konsulentët në vijim të konsultimeve paraprake me CEB-in në lidhje me përzgjedhjen e tyre në përputhje me dispozitat e nenit 4.2 dhe me udhëzimet e prokurimit të CEB-it.

CEB-i rezervon të drejtën të caktojë një vëzhgues në komisionin e vlerësimit të tenderit për përzgjedhjen e konsulentëve.

4.7 Detyrimet e bashkëpunimit: Vendi përfitues garanton se përfituesi përfundimtar do të marrë përsipër të sigurojë që punonjësit e saj përkatës do të bashkëpunojnë në çdo kohë me CEB-in dhe konsulentët në lidhje me ofrimin e shërbimeve të konsulencës.

4.8 Ndihma me rregulloret lokale: Konsulentët mund të kërkojnë ndihmën e përfituesit përfundimtar në marrjen e kopjeve të ligjeve vendore, rregulloret dhe informacionet, të cilat mund të ndikojnë te konsulentët në përmbushjen e detyrimeve të tyre në kontratat e konsulencës, dhe përfituesi përfundimtar duhet të sigurojë këtë asistencë të kërkuar.

Në bazë të ligjeve dhe rregulloreve mbi punën e jashtme në Shqipëri, vendi përfitues dhe përfituesi përfundimtar do të bëjnë përpjekjet e tyre maksimale për të garantuar që punonjësit e konsulentëve dhe vartësit e tyre të marrin vizat dhe lejet e nevojshme, duke përfshirë lejet e punës dhe të qëndrimit, për raste kur është e zbatueshme.

4.9 Vlerësimi i shërbimeve të konsulencës: Vendi përfitues pajtohet me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje për të lejuar çdo person, duke përfshirë, por jo vetëm, konsulentët e jashtëm, të caktuar herë pas here nga CEB-i për të kryer vlefshmërinë e aspekteve të caktuara të shërbimeve të konsulencës të kryera nga konsulentët.

Neni 5

Sipërmarrjet e mëtejshme: Angazhimi me integritet, mjedisi dhe të drejtat e njeriut

5.1 Vendi përfitues/përfituesi përfundimtar garanton se ai nuk ka kryer dhe sipas dijenisë së tij nuk ka person që tashmë ka kryer, dhe merr përsipër se nuk do të kryejë, dhe asnjë person, me pëlqimin e tij ose njohuri paraprake, nuk do të kryejë, në lidhje me zbatimin e shërbimeve të konsulencës apo ekzekutimin e ndonjë kontrate nën shërbimet e konsulencës, një praktikë të korruptuar, mashtruese, detyruese ose marrëveshjeje të fshehtë (më poshtë bashkërisht të referuara si "praktikat e ndaluara").

5.2 Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

"Praktikë e korruptuar është ofrimi, dhënia, marrja apo kërkimi, drejtpërdrejt apo tërthorazi, i çfarëdo objekti me vlerë për të ndikuar në mënyrë të paligjshme te veprimet e një pale tjetër";

"Praktikë mashtruese është çdo veprim apo mosveprim, duke përfshirë dhe keqpërfaqësimin, që me dashje ose nga pakujdesia mashtron apo synon të mashtrojë një palë për të marrë një përfitim financiar ose përfitim tjetër ose për të shmangur një detyrim";

"Praktikë shtrënguese është cenimi ose dëmtimi apo rreziku për të cenuar ose dëmtuar, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ndonjë palë apo pronën e palës për të ndikuar padrejtësisht te veprimet e një pale";

"Praktikë me marrëveshje të fshehtë është një marrëveshje ndërmjet dy ose më shumë palëve, e hartuar për të arritur një qëllim të papërshtatshëm, duke përfshirë ndikimin në mënyrë të paligjshme te veprimet e një pale tjetër".

5.3 Vendi përfitues duhet të garantojë që përfituesi përfundimtar, FSHZH, të mbajë në përputhje me procedurat e brendshme dhe kontrollet, në përputhje me ligjet kombëtare dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, për qëllime të shmangies që shuma e FEPBP-së të përdoret: i) me qëllim të pastrimit të parave; ose ii) me qëllim të financimit të terrorizmit, në veçanti, vendi përfitues duhet të sigurojë që asnjë transaksion nuk është kryer ose në interes të ndonjë prej individëve apo institucioneve të caktuara në listat e personave të sanksionuar, të shpallur nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose të komisioneve të tij në pajtim me rezolutat e Këshillit të Sigurimit 1267 (1999), 1373 (2001) (në dispozicion në faqen e internetit http:/www.un.org/terrorism), të përditësuar herë pas here dhe/ose nga Këshilli i Bashkimit Evropian në përputhje me pozicionet e saj të përbashkëta 2001/931/CSFP dhe 2002/402/CSFP dhe rezolutat e tyre të lidhura ose pasardhëse dhe/ose aktet zbatuese në lidhje me financimin e çështjeve të terrorizmit.

5.4 Vendi përfitues merr përsipër të garantojë që përfituesi përfundimtar ndërmerr:

- të informojë CEB-in nëse vihet në dijeni për ndonjë pamundësi të supozuar ose të dyshuar për t'u pajtuar me sipërmarrjet e mësipërme;

- atë veprim që CEB-i mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të hetuar dhe/ose ndërprerë çdo akt apo mospërmbushje të sipërmarrjeve të mësipërme të supozuara ose të dyshuara;

- të lehtësojë çdo hetim që CEB-i mund të kryejë në lidhje me një veprim ose moszbatim të sipërmarrjeve të mësipërme; dhe

- të informojë CEB-in për masat e marra për të

kërkuar dëmshpërblim nga personat përgjegjës për çdo humbje të rezultuar nga ndonjë veprim apo pamundësi për të përmbushur ndërmarrjet e mësipërme.

5.5 Mjedisi: Zbatimi i shërbimeve të konsulencës duhet të jetë në përputhje me politikat mjedisore të CEB-it.

5.6 Të drejtat e njeriut: Zbatimi i shërbimeve të konsulencës nuk duhet të çojë në një shkelje të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe të Kartës Sociale Evropiane.

Neni 6

Kërkesat e informacionit

6.1 Dokumentet që duhet të ruhen: Vendi përfitues ndërmerr: i) për të ruajtur në ambientet e FSHZH-së, për inspektim gjatë 6 (gjashtë) viteve nga lidhja e çdo kontrate të financuar nga mjetet e grantit të FEPBP-së, kushtet e plota të kontratës, si dhe të gjitha dokumentet materiale që lidhen me procesin e prokurimit dhe ekzekutimin e kontratës; dhe ii) të garantojë që CEB-i të mund të inspektojë dokumentet kontraktuale që kontraktuesi është i detyruar të mbajë në bazë të kontratës së tij të furnizimit.

6.2 Të dhënat e kontabilitetit që duhet të mbahen: Përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja do të mbajë regjistra llogarie në lidhje me shërbimet e konsulencës, të cilët do të jenë në përputhje me standardet ndërkombëtare, duke përcaktuar në çdo kohë gjendjen e progresit të shërbimeve të konsulencës dhe të cilët duhet të regjistrojnë të gjitha veprimet e kryera dhe të identifikojnë asetet dhe shërbimet e financuara me ndihmën e grantit të FEPBP-së.

6.3 Detyrimi për t'iu përgjigjur kërkesës për informacione: Përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja merr përsipër t'i përgjigjet, me një kopje të Ministrisë së Financave të Shqipërisë, brenda një periudhe të arsyeshme, çdo kërkese për informacion nga CEB-i dhe t'u mundësojë atyre me çfarëdo dokumentacioni që CEB-i e çmon të nevojshëm dhe që në mënyrë të arsyeshme mund të kërkojë, zbatimin e duhur të shërbimeve të konsulencës, veçanërisht për sa i përket monitorimit të shërbimeve të konsulencës dhe përdorimit të grantit të FEPBP-së.

6.4 Detyrimi për të informuar: Vendi përfitues, nëpërmjet përfituesit përfundimtar, FSHZH-së, duhet të informojë CEB-in menjëherë për çdo ndryshim legjislativ ose rregullator në sektorin ekonomik përkatës të projektit, dhe, në një kuptim të përgjithshëm, për çdo ngjarje që mund të ketë ndikim material negativ tek ekzekutimi i detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje. Përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja, kur të komunikojë një ndryshim të tillë legjislativ ose rregullator ndaj CEB-it në emër të vendit përfitues, duhet t'i dërgojë një kopje edhe Ministrisë së Financave. Çdo ngjarje ose pamundësi për të informuar CEB-in, mund të shkaktojë pezullimin, anulimin ose shlyerjen e menjëhershme të grantit të FEPBP-së. Para se të kryhet një pretendim i tillë, duhet të zhvillohen konsultime ndërmjet Palëve.

Neni 7

Monitorimi dhe raportet

7.1 Në lidhje me shërbimet

Vendi përfitues siguron se përfituesi përfundimtar do të marrë përsipër:

a) t'i komunikojë me shkrim CEB-it çdo koment që mund të ketë për rezultatet e shërbimeve të konsulencës;

b) që menjëherë të informojë CEB-in për çdo fakt ose ngjarje, të njohura për përfituesin përfundimtar, që mund të ndikojë ose cenojë ndjeshëm përfundimin e shërbimeve të konsulencës;

c) të ndjekë zbatimin e shërbimeve të konsulencës, të miratojë të gjitha raportet (siç përmendet në përshkrimin teknik në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje) pasi të ketë marrë me shkrim moskundërshtimin e CEB-it në versionin përfundimtar të këtyre raporteve, të dërgojë një kopje të versionit përfundimtar të këtyre raporteve për CEB-in;

d) të bëjë përpjekje të arsyeshme për të mundësuar lejen për çdo përfaqësues të autorizuar të CEB-it për të komunikuar me konsulentët dhe nëse është e nevojshme për t'i vizituar ata, me qëllim marrjen e të gjitha informacioneve të tilla që CEB mund të kërkojë në lidhje me ecurinë e shërbimeve të konsulencës; dhe

e) të komunikojë raportet vjetore të progresit për zbatimin e shërbimeve të asistencës teknike dhe një raport përfundimi sipas kërkesave të CEB-it brenda tre (3) muajve pas datës së përfundimit sipas projektit (siç përcaktohet në shtojcën A), të cilat duhet të mbulojnë të paktën informacionet që gjenden në modelin e dhënë në shtojcën D të kësaj Marrëveshjeje (formati i raportimit). Raporti përfundimtar do të përfshijë një vlerësim të performancës së projektit kundrejt objektivave, si dhe një vlerësim të përdorimit dhe të ndikimit të grantit të FEPBP-së.

Raportimi mbi shpenzimet e bëra duhet të shprehet në euro.

Raportet specifike për zbatimin e shërbimeve të përgatitura nga përfituesi përfundimtar dhe/ose ato

të përgatitura nga konsulentët e financuar me të hyrat nga granti, duhet të përmbajnë paralajmërimin e mëposhtëm: "Ky dokument është përgatitur me ndihmën financiare të Fondit të Përbashkët të Evropës për Ballkanin Perëndimor sipas kuadrit të investimeve për Ballkanin Perëndimor. Pikëpamjet e shprehura janë ato të (emri i autorit) dhe, si rrjedhojë, në asnjë mënyrë nuk mund të pasqyrojnë opinionin zyrtar të kontribuuesve të Fondit të Përbashkët të Evropës për Ballkanin Perëndimor ose BEI apo BERZH-i si bashkëmenaxherët e Fondit të Përbashkët të Evropës për Ballkanin Perëndimor".

7.2 Në lidhje me vendin përfitues dhe përfituesin përfundimtar

a) Vendi përfitues duhet, në përgjithësi, të informojë CEB-in për çdo fakt apo ngjarje që mund të pengojë përmbushjen e ndonjë detyrimi të vendit përfitues ose përfituesit përfundimtar sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) Vendi përfitues siguron se përfituesi përfundimtar do të marrë përsipër të paraqesë pranë CEB-it, pa vonesë, çdo dokument të kërkuar nga ky i fundit, duke përfshirë, por jo vetëm, raportet e auditimit apo pasqyrat e kontabilitetit.

7.3 Vizitat

a) Përfituesi përfundimtar duhet të ftojë CEB-in të marrë pjesë në ndonjë nga misionet e tij të vlerësimit që do të kryhet gjatë ose pas përfundimit të shërbimeve të konsulencës.

b) Vendi përfitues merr përsipër të pranojë pozitivisht të gjitha misionet e monitorimit të kryera nga punonjësit, e: i) CEB-it; dhe ii) BEI-t, duke vepruar në cilësinë e tij si kontribuues në FEPBP; dhe iii) Bashkimit Evropian (BE), duke përfshirë cilindo nga organet e tij kompetente; ose iii) konsulentë të jashtëm të punësuar nga CEB-i dhe të garantojë të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm për misionet e tyre të monitorimit, duke lehtësuar çdo vizitë të mundshme në terren.

7.4 Auditimi:

Vendi përfitues merr përsipër të pranojë pozitivisht ndonjë auditim të kryer nga punonjësit e: i) CEB-it; dhe ii) BEI-t, duke vepruar në cilësinë e tij si kontribuues në FEPBP; dhe iii) të BE-së, duke përfshirë cilindo nga organet e tij kompetente; ose iii) auditues të jashtëm të punësuar nga CEB-i dhe të garantojë të gjithë bashkëpunimin e nevojshëm për auditimin e tyre, duke lehtësuar çdo vizitë të mundshme. Në veçanti, CEB-i, BEI dhe Bashkimi Evropian, duke përfshirë edhe Gjykatën e saj të Audituesve, Zyra e BE-së Kundër mashtrimit (OLAF), Komisioni Evropian dhe çdo organ tjetër kompetent i BE-së mund të kryejë një kontroll në terren të shërbimeve të konsulencës, të kryera nga një ose më shumë konsulentë sipas zgjedhjes së tij, duke përfshirë edhe rastin e vonesës nga vendi përfitues për sa i përket ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

CEB-i mund të realizojë auditime në terren të llogarive të shërbimeve të konsulencës të mbajtura nga një ose më shumë konsulentë me zgjedhjen e tij, me kosto që do të përballohen nga vendi përfitues, në rastin e një mospërmbushjeje detyrimesh nga ky i fundit të ndonjë prej detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

7.5 Përhapja/shpërndarja e dokumenteve: Vendi përfitues pranon se CEB-i mund të jetë i detyruar të shpërndajë dokumente të tilla në lidhje me përfituesin përfundimtar dhe konsulentët e Gjykatës së Audituesve të Bashkimit Evropian, të cilat janë të nevojshme për kryerjen e detyrave të organit të BE-së, në përputhje me ligjin e BE-së.

Neni 8
Tarifat

8.1 Taksat, detyrimet dhe tarifat: Vendi përfitues duhet të paguajë të gjitha taksat, detyrimet apo tarifat e çfarëdo natyre, duke përfshirë taksën e vulës dhe tarifat e regjistrimit, të cilat rrjedhin nga ekzekutimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje dhe dokumentet që lidhen me to, në përputhje me ligjet e zbatueshme vendore.

8.2 Tarifat e tjera: Vendi përfitues dhe përfituesi përfundimtar do të paguajnë tarifat e tyre profesionale dhe bankare dhe çdo tarifë transferte apo këmbimi, të kryera për ekzekutimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe kontratat e konsulencës.

Neni 9
Shkelja e detyrimit

9.1 E drejta për të pezulluar, anuluar ose kërkuar shlyerjen: CEB-i rezervon të drejtën të pezullojë, anulojë ose të kërkojë kthimin e menjëhershëm të grantit të FEPBP-së në ndonjë prej rrethanave të mëposhtme:

i) Shkelja e detyrimit sipas kësaj Marrëveshjeje: nëse vendi përfitues ose përfituesi përfundimtar nuk përmbushin ndonjë detyrim të vendosur mbi to, sipas kësaj Marrëveshjeje, brenda një kohe të caktuar në mënyrë të arsyeshme, me një njoftim të hartuar nga CEB-i për vendin përfitues ose përfituesin përfundimtar që kërkon përmbushjen e detyrimeve;

ii) Shkelja e detyrimit: kur vendi përfitues nuk mund të përmbushë një detyrim që rrjedh nga ndonjë marrëveshje huaje apo marrëveshje garancie ose marrëveshje granti dhe kur interesat

dhe objektivat e CEB-it, si rrjedhojë, janë cenuar;

iii) Mospagimi: kur vendi përfitues (si huamarrës ose garantues) nuk paguan ndonjë shumë të principalit, interesit ose shuma të tjera të pagueshme në bazë të ndonjë marrëveshjeje huaje apo marrëveshjeje garancie ndërmjet CEB-it dhe vendit përfitues në datën në të cilën shuma pritet të paguhet;

iv) Ndryshimi material negativ: kur një situatë e jashtëzakonshme lind, e cila sipas mendimit të CEB-it e bën të pasigurt përmbushjen e detyrimeve të vendit përfitues (si huamarrës apo garantues ose si marrës të grantit); dhe

v) Anëtarësimi në CEB: kur vendi përfitues (si huamarrës ose garantues apo marrës i grantit) nuk është më anëtar i CEB-it.

9.2 Të drejtat e tjera sipas ligjit: paragrafi 9.1 i këtij neni nuk do të kufizojë ndonjë të drejtë tjetër të CEB-it për të kërkuar kthimin e grantit të FEPBP-së.

Neni 10
Detyrimet e Palëve

Vendi përfitues duhet të dëmshpërblejë CEB-in për çdo dëm, humbje, kostot dhe shpenzimet e pësuara ose të shkaktuara nga CEB-i, ndër të tjera, si pasojë e ndonjë veprimi ose mosveprimi të kryer prej tij ose përfituesi përfundimtar, nga dështimi i tij apo i përfituesit përfundimtar, për të përmbushur ndonjë nga detyrimet e tyre përkatëse të përcaktuara në këtë Marrëveshje, për neglizhencë flagrante, për çdo akt të shpërdorimit të detyrës me paramendim dhe për çdo veprim mashtrues.

CEB-i nuk do të jetë përgjegjës për vendin përfitues ose përfituesin përfundimtar për çdo veprim apo mosveprim të konsulentëve ose për dështimin e konsulentëve për të ofruar shërbimet e konsulencës në përputhje me kontratat e konsulencës. Megjithatë, vendi përfitues apo përfituesi përfundimtar mund t'i kërkojë CEB-it të bien dakord për një ndryshim të nevojshëm të konsulentëve nëse performanca e tyre, sipas mendimit të vendit përfitues ose përfituesit përfundimtar rezulton të jetë e pakënaqshme, ose nëse konsulentët kryejnë ndonjë akt të padëshirueshëm ose mosveprim. Përfituesi përfundimtar, FSHZH-ja, kur i komunikon një kërkesë të tillë CEB-it duhet t'i dërgojë një kopje Ministrisë të Financave.

Përfituesi përfundimtar duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të përmbushur të gjitha kërkesat nga ana e CEB-it në përputhje me kontratat e konsulencës.

Neni 11
Fshehtësia

CEB-i do të trajtojë çdo informacion të dhënë nga vendi përfitues ose përfituesi përfundimtar në pajtim me detyrimet e këtij të fundit, në përputhje me rregullat e tij normale të fshehtësisë.

Neni 12
Njoftimet

12.1 Çdo njoftim që do t'i jepet secilës Palë dhe çdo komunikim tjetër në lidhje me Marrëveshjen (përveç atyre që ngrihen nga procesi gjyqësor) do të bëhet në mënyrë efektive ose do të dërgohet me letër rekomande ose letër me konfirmim të regjistruar marrjeje apo faks për Palët në adresat më poshtë. Adresa e secilës Palë mund të ndryshohet nga njoftimet në mënyrën e përcaktuar në këtë dispozitë.

12.2 Çdo njoftim për CEB-in duhet t'i drejtohet:

Bankës për Zhvillim të Këshillit Evropës
55, rruga Kléber
75784 Paris Cedex 16 – France

Në vëmendje të:
Drejtorisë për Huat dhe Zhvillimin Social
Drejtori, Departamenti i Projekteve

Faks: +33 1 47 55 37 52

Kopje për:
Drejtorinë për Bashkëpunimin Evropian
dhe Strategjinë
Faks: +33 1 47 55 37 82

12.3 Çdo njoftim për vendin përfitues duhet të drejtohet në:

Ministria e Financave
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", nr. 3
Tiranë, Shqipëri

Në vëmendje të:
Ministrit të Financave
Faks: +355 4 222 8494

Kopje për: Fondin Shqiptar të Zhvillimit
Në vëmendje të:
Drejtorit Ekzekutiv të FSHZH-së
Faks: +355 4 2234 885

Neni 13
Amendamentet

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me amendament me shkrim nga CEB-i dhe vendi përfitues.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

14.1 Çdo mosmarrëveshje që lind nga ose në lidhje me Marrëveshjen, duke përfshirë ekzistencën e saj, vlefshmërinë, interpretimin ose ndërprerjen do të zgjidhet miqësisht ndërmjet Palëve.

14.2 Në mungesë të zgjidhjes miqësore, mosmarrëveshjet midis Palëve në lidhje me Marrëveshjen për grantin e FEPBP-së do t'i nënshtrohen arbitrazhit sipas termave dhe kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të rregulloreve të huas siç është përcaktuar në shtojcën C të këtij dokumenti.

Palët bien dakord për të mos përfituar nga ndonjë privilegj, imunitet apo legjislacion para një autoriteti juridiksional ose autoriteti tjetër, qoftë vendës apo ndërkombëtar, në mënyrë që të kundërshtojnë ekzekutimin e një vendimi të dhënë në bazë të kushteve të përcaktuara në kapitullin 4 të rregulloreve të huas, siç është përcaktuar në shtojcën C të këtij dokumenti.

Për qëllimet e shtojcës C, në kontekstin e grantit të FEPBP-së, termat e mëposhtëm do të kenë tekstin si vijon:

- "Hua" duhet të fshihen dhe të zëvendësohen me "Grantet e FEPBP-së";
- "Marrëveshje huaje dhe, kur është e zbatueshme, marrëveshje garancie" dhe "kontrata e huas ose kontrata e garancisë" do të hiqen dhe zëvendësohen me "Marrëveshjen e grantit"; dhe
- "Huamarrësi" apo "huamarrësi dhe garantuesi (nëse ka)" fshihet dhe zëvendësohet me "vendi përfitues".

Neni 15

Hyrja në fuqi

Pas nënshkrimit të saj nga CEB-i dhe vendi përfitues, Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit pasardhës pas datës në të cilën Republika e Shqipërisë ka njoftuar CEB-in për përfundimin e procedurave të brendshme, të nevojshme për këtë qëllim.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar Marrëveshjen në gjuhën angleze në dy (2) kopje origjinale.

Nënshkruar në [●],
Më [●],

.....
Për Bankën për Zhvillim të Këshillit të Evropës
[Mikolaj Dowgielewicz
Zëvendësguvernatori]

.....
Për vendin përfitues

SHTOJCA A
PËRSHKRIMI TEKNIK I SHËRBIMEVE TË KONSULENCËS
(PËR PËRGATITJEN E PROJEKTIT)

Projekti	Projekti konsiston në ofrimin e asistencës teknike - në formën e shërbimeve të konsulencës, që do të prokurohen nga përfituesi përfundimtar për të analizuar situatën aktuale dhe do të përgatisë një masterplan, duke pasur parasysh potencialin e tij turistik për zhvillimin e zonës, duke përcaktuar ndërhyrjet prioritare për përmirësimin e infrastrukturës komunale dhe shërbimeve publike themelore. "Punimet në infrastrukturën komunale në zonën e Alpeve Shqiptare", të miratuar nga këshilli drejtues i JGF-së, më 7 dhjetor 2011, dhe konsiderohet në këtë Marrëveshje si granti i FEPBP-së, do të mbështesë vendin përfitues për të nxitur zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të komuniteteve të zonës së Alpeve Shqiptare, duke u fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës themelore komunale dhe shërbimet, me qëllim të përmirësimit të drejtpërdrejtë të kushteve të jetesës së popullsisë banuese. E vendosur në pjesën veriore të Shqipërisë, administrativisht zona përbëhet nga dhjetë njësi rurale të qeverisjes vendore (komuna) në rajonet e Shkodrës dhe të Kukësit. Të dhjetë NJQV-të janë të bazuara në ndarjen aktuale territoriale. Megjithatë, në bazë të ligjit "Për ndarjen e re territoriale" të datës 31 korrik 2014, zona e synuar e projektit do të konsolidohet në katër njësi të qeverisjes vendore, duke u bashkuar me komunat fqinje/komunat e tjera. Si rrjedhojë, zona do të jetë pjesë e katër NJQV-ve të ardhshme: 1) Shkodër; 2) Vau i Dejës; 3) Malësi e Madhe; dhe 4) Tropojë. Megjithatë, pjesa gjeografike e Alpeve Shqiptare përbën territorin që është zona e synuar e detyrës, e cila do të përpiqet të zbatojë një qasje rajonale ndërkufitare, duke hetuar zhvillimet në harmoni me vendet fqinje. Zona karakterizohet nga papunësia e lartë e shoqëruar me një gjendje të dobët të infrastrukturës, siç janë rrugët, menaxhimi i ujit/ujërave të zeza, institucionet shëndetësore dhe arsimore, si dhe mbrojtjen nga përmbytjet.
Shteti	Republika e Shqipërisë
Subjekti zbatues	Fondi Shqiptar i Zhvillimit (gjithashtu, "Përfituesi përfundimtar")
Përfituesit fundorë	35,000 banorët e zonës së Alpeve Shqiptare, si dhe vizitorët/turistët.
Miratimi nga komiteti drejtues i KIBP-së	7 dhjetor 2011
Shuma e grantit të FEPBP-së	1 000 000 euro
Punimet e planifikuara	Granti i FEPBP-së do të përdoret për të arritur dy rezultate të mëdha për të lehtësuar përgatitjen dhe zbatimin e projektit që do të financohet me Hua të CEB-it LD 1853 (2014): 1. Masterplani për zhvillimin e zonës së Alpeve Shqiptare: Bazuar në konsultimet palëve të interesuara dhe duke ndjekur kuadrin e ri ligjor për planifikimin territorial në vend, rezultati i parë i projektit duhet të jetë përgatitja e një masterplani për zhvillimin e zonës. Më konkretisht, rezultatet e masterplanit do të jenë: - Vlerësimi social-ekonomik (i popullsisë dhe i dinamikave demografike, financimi i burimeve natyrore dhe njerëzore, plani i shfrytëzimit të tokës për zonën, aktivitetet kryesore ekonomike dhe potencialin e zhvillimit, duke përfshirë edhe agroturizmin etj.) - Plani i zhvillimit të infrastrukturës komunale i fokusuar kryesisht në qasjen e rrugëve rurale, menaxhimin e mbetjeve, menaxhimin e ujit dhe të ujërave të zeza, mbrojtjen nga përmbytjet dhe kontrollin e erozionit. - Përgatitja e hartave të hollësishme tematike për zonat e ndërhyrjeve. Koha e parashikuar për të arritur rezultatet e mëposhtme është:

	- Vlerësimi i situatës aktuale dhe kërkesës së turizmit, si dhe përcaktimi i një "zone për rast studimor" (4 muaj + 2 muaj për miratim); - Plani i integruar ndër-sektorial dhe plani lokal i detajuar për një "zonë studimi rasti" (12 muaj + 2 muaj për miratim); - Propozimi i marketingut (dy muaj). 2. Studimi i fizibilitetit për punimet kryesore në infrastrukturën komunale që do të financohen nga huaja e ardhshme nga CEB-i. Duke u bazuar në gjetjet dhe rekomandimet nga masterplani, do të përgatitet një studim fizibiliteti për të përcaktuar ndërhyrjet që do të paraqiten në planin e zhvillimit të infrastrukturës komunale: - Të shqyrtojë të gjitha aspektet teknike, financiare ekonomike, sociale dhe mjedisore të rëndësishme të planit zhvillimor të infrastrukturës komunale; - Përgatitja e një programi efektiv dhe në faza të investimeve, bazuar në konstatimet e masterplanit (veçanërisht planit zhvillimor të infrastrukturës komunale); - Përgatitja e hartave të hollësishme dhe dokumenteve të tenderit për projektet kryesore të infrastrukturës me prioritet të lartë që do të financohen nëpërmjet huas nga CEB-i LD 1853 (2014); Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për zbatimin e huas të CEB-it LD 1853 (2014), duke theksuar marrëveshjet e zbatimit (prokurimit, mbikëqyrjes etj.). Koha e parashikuar për të përfunduar programin e investimeve komunale është 4 muaj (+ 2 muaj për miratimin e tij), dhe duhet të përfshijë elementet e mëposhtme: - Raportin dhe hartën gjeografike të infrastrukturës ekzistuese dhe të propozuar komunale, si dhe shërbimet publike; - Programin e investimit strategjik afatgjatë; - Programin e investimit afatshkurtër; - Studimet e fizibilitetit të infrastrukturave të propozuara komunale të përfshira në programin e investimeve afatshkurtra që do të financohen nga huaja e CEB-it LD 1853 (2014); - Projektimin teknik të infrastrukturës komunale të propozuar për t'u financuar nga huaja e CEB-it LD 1853 (2014); - Dosjen e tenderit të infrastrukturave komunale të propozuara që do të financohen nga huaja e CEB-it LD 1853 (2014).
Monitorimi dhe raportimi	Vendi përfitues do të komunikojë raportet vjetore të progresit për zbatimin e shërbimeve të asistencës teknike, dhe raportit përfundimtar, sipas pëlqimit të CEB-it, brenda tre muajve pas datës së përfundimit. Raporti përfundimtar do të përfshijë një vlerësim të performancës së projektit ndaj objektivave, një vlerësim të përdorimit dhe të ndikimit të grantit të FEPBP-së, si dhe masterplanin dhe raportin e fizibilitetit. Të gjitha dërgesat, duke përfshirë edhe raportet e lartpërmendura dhe rezultatet kryesore të AT-së, do të rishikohen në mënyrë të kënaqshme dhe të detajuar nga CEB-i para çdo disbursimi (me përjashtim të së parës).
Plani tregues i financimit të projektit	Shpenzimet totale të pritshme nga shërbimet e konsulencës, të cilat do të rezultojnë në përfundimin e një "Masterplani dhe studimi të fizibilitetit për punët komunale në zonën e Alpeve Shqiptare" janë të barabarta me shumën maksimale (1 milion euro) të grantit të FEPBP të shqyrtuar në këtë Marrëveshje.
Ndikimet sociale	Përfundimet e shërbimeve të konsulencës do të mundësojnë përgatitjen e mëtejshëm të kushteve të nevojshme për zbatimin e programit të huas së CEB-it LD 1853 (2014), i cili pritet të shtojë vlerë të rëndësishme sociale në zonë nëpërmjet uljes së papunësisë dhe numrit të familjeve që jetojnë

	nën nivelin e varfërisë, duke tërhequr investimet në zonë dhe duke përmirësuar kushtet e jetesës së 35,000 banorëve të zonës, duke u fokusuar në përmirësimin e infrastrukturës themelore komunale, si rrugët, menaxhimi i ujit/ujërave të zeza, institucionet shëndetësore dhe arsimore, si dhe mbrojtjen nga përmbytjet.
Vendndodhja	Zona e Alpeve Shqiptare, e cila ndodhet në pjesën veriore të Shqipërisë dhe përbëhet nga 10 njësi rurale të qeverisjes vendore (komuna) në rajonet e Shkodrës dhe të Kukësit, dhe me rreth 35,000 banorë. Dhjetë NJQV-të janë të bazuara në ndarjen aktuale territoriale. Megjithatë, në bazë të ligjit "Për ndarjen e re territoriale" të datës 31 korrik 2014, zona e synuar e projektit do të konsolidohet në katër njësitë e qeverisjes vendore, duke u bashkuar me komunat fqinje/komunat e tjera. Kështu, zona do të jetë pjesë e katër NJQV-ve: 1) Shkodër; 2) Vau i Dejës; 3) Malësia e Madhe; dhe 4) Tropoja. Megjithatë, pjesa gjeografike e Alpeve Shqiptare përbën territorin që është zona e synuar e detyrës.
Programi i punës	Prokurimi publik i shërbimeve të konsulencës filloi në gjysmën e dytë të vitit 2014. Shërbimet e konsulencës do të kryhen gjatë gjithë vitit 2015 dhe 2016. Sipas planit të punimeve, data e përfundimit është caktuar në 30 qershor 2017.
Data e përfundimit	30 qershor 2017
Data e mbylljes	31 dhjetor 2016

SHTOJCA B
KËRKESA PËR DISBURSIM TË KËSTIT TË GRANTIT
(MODELI)

<Data, vendi>
Në vëmendje të:
CEB
Bankës për Zhvillim të Këshillit Evropës
55, rruga Kléber
F- 75116

Titulli i Marrëveshjes së grantit: "Punimet për infrastrukturën komunale në zonën e Alpeve Shqiptare"
Referenca nr. (FIP 17.187 (2010)/LD 1835 (2014)) WB6-ALB-SOC-14
Kërkesë për disbursim numër: <Shkruani numrin>

I nderuar zotëri/zonjë,
Me anë të kësaj shkrese kërkoj disbursimin e <shkruani numrin e kështit> nën Marrëveshjen e grantit të përmendur më lart.
Shuma e kërkuar është <...> euro.
Ju lutem gjeni bashkëlidhur dokumentet e mëposhtme mbështetëse:
-
-
Disbursimi i kështit të grantit duhet të kryhet në llogarinë e projektit të grantit të FEPBP-së me detajet e llogarisë vijuese:
Emri mbajtësit:
Nr. i llogarisë IBAN:
Ref:
Emri i bankës:
Adresa e bankës:
SWIFT BIC:

Me anë të kësaj shkrese vërtetoj se informacioni që përmban kjo kërkesë për disbursim të

kështit të grantit është i plotë dhe i besueshëm, [NUK PËRFSHIHET PËR KËSTIN E PARË TË GRANTIT] dhe se kostot e shkaktuara deri më sot, siç përcaktohet në raportin e progresit, janë të pranueshme në përputhje me termat dhe kushtet e përcaktuara në Marrëveshjen e grantit dhe se kjo kërkesë për disbursim të kështit të grantit është vërtetuar nga dokumentet e duhura dhe të verifikueshme mbështetëse.

Me respekt,

< Nënshkruesi i autorizuar>

SHTOJCA C
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE NË LIDHJE ME GRANTET E FEPBP-së

KAPITULLI 4

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve në lidhje me huat nga Banka ose të garancive të lidhura me to

Neni 4.1
Arbitrazhi

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të marrëveshjes së huas dhe, kur është e zbatueshme, marrëveshjes së garancisë, në lidhje me interpretimin ose zbatimin e marrëveshjeve të tilla ose me një kërkesë nga një prej palëve të drejtuar tjetrës, që rrjedh prej marrëveshjes së huas apo marrëveshjes së garancisë apo rregulloreve të tyre, e cila nuk është zgjidhur me marrëveshje ndërmjet palëve, do të paraqitet për arbitrazh në mënyrën e përcaktuar më poshtë.

Neni 4.2
Fillimi i procedurave të arbitrazhit

Procedurat e arbitrazhit mund të fillohen nga njëra prej palëve të përcaktuara në seksionin paraprak me anë të një kërkese të njoftuar për të gjitha palët e tjera; kërkesa duhet të theksojë natyrën dhe subjektin e mosmarrëveshjes dhe të përcaktojë pretendimet që duhet të paraqiten për arbitrazh.

Neni 4.3
Caktimi i trupit gjykues të arbitrazhit

Në çdo procedurë arbitrazhi të filluar në bazë të këtij neni, huamarrësi ose garantuesi (nëse ka) mund të jetë një palë së bashku me garantuesin ose huamarrësin, sipas rastit.

Për çdo mosmarrëveshje të paraqitur për arbitrazh në zbatim të këtij neni, do të ngrihet një trup gjykues i arbitrazhit. Ai do të përbëhet nga tre arbitra, të caktuar si më poshtë:

a) një arbitër emërohet nga banka;

b) arbitri i dytë duhet të emërohet nga huamarrësi ose, kur është e mundur, me marrëveshje ndërmjet huamarrësit dhe garantuesit ose në mungesë të kësaj marrëveshje, nga garantuesi;

c) një arbitër i tretë i quajtur gjyqtar/arbitër, i cili do të veprojë si kryetar i trupit gjykues të arbitrazhit, duhet të caktohet me pëlqimin e përbashkët ndërmjet palëve, ose në pamundësi, nga ana e kryetarit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ose, nëse ky i fundit ka shtetësi të njëjtë me garantuesin ose ka të njëjtën kombësi si të huamarrësit, nga zëvendëskryetari i Gjykatës, ose nëse edhe ky i fundit është në të njëjtën situatë, nga më i larti i gjyqtarëve të Gjykatës që nuk ka shtetësinë e garantuesit dhe as është i së njëjtës kombësi me huamarrësin;

d) procedura e përshkruar në paragrafin pararendës do të kryhet me kërkesën e njërës prej palëve në mosmarrëveshje, nëse brenda një muaji pas dhënies së njoftimit për kërkesën për arbitrazh, asnjë marrëveshje nuk është arritur për caktimin e një gjyqtari;

e) kur një nga palët nuk cakton një arbitër, gjyqtari do të caktojë arbitrin në fjalë.

Neni 4.4

Vendi i arbitrazhit

Gjykata e arbitrazhit do të zhvillojë seancën e parë në atë orar dhe në atë vend që caktohet nga gjyqtari. Pas kësaj, gjykata do të caktojë vetë ku dhe kur do të zhvillohet seanca e radhës.

Neni 4.5

Ligji i zbatueshëm për procedurat e arbitrazhit

Gjykata e arbitrazhit duhet të marrë vendim për të gjitha çështjet nën kompetencën e saj. Ajo duhet të përcaktojë rregullat e veta të procedurës dhe duhet të zgjedhë rregullin që do të zbatohet, vetëm nëse rregulli është tashmë i përfshirë në kontratat apo marrëveshjen e arbitrazhit, duke pasur parasysh dispozitat e nenit 1/3 të Protokollit të Tretë të Marrëveshjes së Përgjithshme për Privilegjet dhe Imunitetet të Këshillit të Evropës. Të gjitha vendimet e gjykatës duhet të merren me shumicë votash.

Legjislacioni i brendshëm mund të zbatohet për një rast të veçantë kur nuk derogon nga protokolli i tretë i marrëveshjes së përgjithshme për privilegjet dhe imunitetet të Këshillit të Evropës, dhe nga nenet e Marrëveshjes.

Neni 4.6

Vendimi i trupit gjykues të arbitrazhit

Të gjitha vendimet e gjykatës së arbitrazhit do të përcaktojnë bazat/arsyet për vendimin. Këto vendime do të jenë të formës së prerë dhe detyruese për të gjitha palët e përmendura në nenin 4.3. Ato mund të jenë dhënë në mungesë të parashtrimeve.

Neni 4.7

Shpenzimet e arbitrazhit

Pala kundër së cilës është marrë vendimi do të marrë përsipër shpenzimet e procedurave të arbitrazhit, nëse gjykata e arbitrazhit nuk vendos ndryshe, ose palët kanë vendosur ndryshe me anë të ndonjë klauzole në kontratën e huas apo garancisë. Gjykata e arbitrazhit duhet të japë një vendim të formës së prerë për çdo konflikt në lidhje me shpenzimet.

Neni 4.8

Ekzekutimi i vendimeve të arbitrazhit

Marrëveshja e huas dhe marrëveshja e garancisë duhet të përmbajnë çdo dispozitë që kërkohet për të siguruar, në lidhje me Bankën dhe me huamarrësin dhe garantuesin, pajtueshmëri me çdo vendim të marrë në zbatim të këtij kapitulli.

Nëse brenda një muaji pasi vendimi fillestar u është dorëzuar palëve, ky vendim nuk është përmbushur, secila prej palëve të përmendura në nenin 4.3 mund të fillojë procedime për zbatimin e vendimit. Gjykata e cila ka juridiksion për këto procedime duhet të caktohet nga rregullat e procedurës civile së shtetit përkatës.

SHTOJCA D
MODELI I RAPORTIMIT
RAPORTI I PROGRESIT TË PROJEKTIT DHE PËRDITËSIMI FINANCIAR

Numri i kërkesës së kontributit:	

OPERACIONI	
Titulli i operacionit të përgjithshëm: (Projektet e miratuara në një komitet drejtues mund të përmbajnë një ose më shumë kontrata të udhëhequr/a nga një ose më shumë INF)	
Shteti/et:	
Përfituesi/ët:	
Sektori:	
Nënsektori:	
Shuma totale e miratuar për operacionin: (siç u miratua në komitetin drejtues)	
Data e miratimit të financimit: (data e komitetit drejtues)	
Burimi i financimit për operacionin: (duke renditur të gjitha burimet e financimit të miratuara në komitetin drejtues)	

KJO KONTRATË	
Titulli i kësaj KONTRATE: (i njëjtë si "Titulli i operacionit të përgjithshëm" nëse ka më shumë se një kontratë KT sipas operacionit)	
Drejtuesi i INF-së	
Vlera: (e miratuar për përdorim nga FEPBP-ja)	
Shuma totale e livruar:	
Shuma për t'u kthyer te FEPBP-ja: (nëse është e zbatueshme)	
Data e përfundimit të kontratës: (aktuale/e pritshme)	
Kontratat e lidhura sipas këtij operacioni: (lista e kontratave, vlerat dhe burimet e konfirmuara financimit)	
PROGRESI I PROJEKTIT	
Përshkrimi i projektit: (Ju lutem, jepni një përshkrim të shkurtër të investimit/eve, duke përfshirë: - Një përshkrim të kësaj kontrate specifike (ose të operacionit nëse është identik me kontratën); - Një përditësim mbi statusin e kontratës/operacionit, duke përfshirë çdo problem për t'u zgjidhur; - Gjendjen e kontratave të lidhura (kur ka më shumë se një kontratë që mbështet një operacion).	